

199/22
12.04.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E AUDITIMIT

Nr. 2998/2 prot.

Tiranë, më 07.04.2023

Lënda : Dërgim i Raportit Final të Auditimit mbi zbatimin e rekomandimeve

**Drejtuar: Znj. MAJLINDA PËRRIU
PREFEKTIT TË QARKUT**

ELBASAN

E nderuar znj. Përriu,

Bashkëlidhur dërgojmë Raportin Final të Auditimit, mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në Raportin Final të Auditimit dërguar me shkresën e MB nr.prot.1527/5 datë 16.05.2022 pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan.

Auditimi u krye nga grupi i auditimit të Drejtorisë së Auditimit në Ministrinë e Brendshme, Maria Markaj e Arbëresha Zyka në zbatim të urdhrit të Ministrit të Brendshëm nr.199, datë 17.10.2022 "Për auditimin e njërive shpenzuese të Programit Buxhetor "Policia e Shtetit" për vitin 2023", Autorizimit për fillimin dhe përgatitjen e angazhimit të auditimit në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan prot.nr.2998 datë 15.03.2023 dhe Programit të punës prot.nr.2998/1 datë 16.03.2023. Zbatimi i rekomandimeve të AB sipas afatit të përcaktuar në Planin e veprimit dhe raportimi mbi progresin e realizimit të tyre deri në përfundimin e plotë të realizimit të tyre, është detyrim ligjor.

Në zbatim të pikës d, të nenit 12 "Përgjegjësitë e titullarëve të njësive publike" të ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015, "Për auditin e brendshëm në sektorin publik" dhe pikës 4.1.13.3 "Përgjegjësia e njësive për të zbatuar rekomandimet e AB", për t'u siguruar se çdo rekomandim i lënë nga njësia e AB, zbatohet ashtu siç duhet, të merren në analizë rekomandimet e mbetura në proces realizimi dhe të kërkohet zbatimi i tyre nga strukturat përgjegjëse sipas afatit të parashikuar në Planin e veprimit duke raportuar pranë DA në MB nga personi i kontaktit mbi progresin e bërë lidhur me zbatimin e tyre deri në realizimin përfundimtar të gjithë rekomandimeve.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR I AUDITIMIT

Arjan SULAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME

DREJTORIA E AUDITIMIT

RAPORT FINAL AUDITIMI

**MBI
AUDITIMIN E ZBATIMIT TË
REKOMANDIMEVE TË LËNA
NË INSTITUCIONIN E PREFEKTIT TË
QARKUT ELBASAN**
(me shkresën e MB nr.1527/5 datë 16.05.2022)

GRUPI I AUDITIMIT

**Maria MARKAJ
Arbëresha ZYKA**

Prill 2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E AUDITIT

RAPORT FINAL AUDITIMI

Mbi

Auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e kryer gjatë vitit 2022, në
Institucionin e Prefektit Qarkut Elbasan

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

- ✓ Një përshkrim të shkurtër të subjektit, fushës/sistemit që do auditohet, objektivit dhe qëllimit:

Drejtorja e Auditimit në Ministrinë e Brendshme, për vitin 2023 ka planifikuar të realizojë gjatë periudhës nga data 16.03.2023 deri me datë 03.04.2023, një mision auditimi për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e kryera gjatë vitit 2022.

Ndër auditimet e kryera gjatë vitit 2022 është dhe auditimi i veprimtarisë së Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan për periudhën nga 01.07.2019 deri më 31.12.2021. Në raportin final të auditimit dërguar në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan me shkresën e MB nr. shkresës nr.1527/5 prot, datë 16.05.2022 “Dërgim i Raportit final të Auditimit” janë lënë për ndjekje e zbatim gjithsej 7 rekomandime si dhe nga auditimet e mëparshme kane rezultuar dhe 2 rekomandime në proces zbatimi.

Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan për zbatimin e rekomandimeve të lëna në Raportin final, ka hartuar miratuar dhe dërguar në DA në MB “Planin e veprimt” të zbatimit të rekomandimeve dhe me shkresën nr.1527/6, datë 17.06.2022, në të cilin janë përfshirë të gjitha rekomandimet, është përcaktuar personeli për zbatimin e rekomandimeve si dhe afatet e zbatimit të tyre.

Auditimi për zbatimin e rekomandimeve, u krye në zbatim të Planit vjetor 2023 miratuar me urdhrin e Ministrit nr.199, datë 17.10.2022, “Për auditimin e brendshëm në strukturat e Ministrisë së Brendshme për vitin 2023” dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”.

Objektivi auditimit: Të sigurojmë Titullarin mbi situatën dhe statusin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e kryera gjatë vitit 2022.

Qëllimi i auditimit: Vlerësimi i statusit të zbatimit të rekomandimeve, me qëllim përmirësimin e fushave/sistemeve në të cilat janë konstatuar gjetje dhe për të cilat janë lënë rekomandime, masat e ndërmarra në respektim të afateve për zbatimin dhe raportimin mbi zbatueshmërinë e këtyre rekomandimeve.

- ✓ Rezultatet e auditimit, përmbledhje e gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve kryesore:

Nga auditimi në Institucionin e Prefektit Qarkut Elbasan sipas pikave të programit në të cilin janë identifikuar çështjet që do auditohen dhe kriteret e vlerësimit, rezultoi se për gjetjet e konstatuara gjatë procesit të auditimit në vitin 2022, nga Drejtoria e Auditimit janë lënë për ndjekje dhe zbatim gjithsej 9 rekomandime (nga të cilat 2 rekomandime kanë rezultuar nga auditimet e mëparshme dhe 7 rekomandime janë lënë nga auditimi i fundit) të cilat janë pranuar dhe ka filluar zbatimin e tyre, duke përfunduar së realizuari 7 rekomandime ose 78 %, ndërsa 2 rekomandime ose 22 %, ishin në proces zbatimi por pa përfunduar plotësisht. Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi është detyrim ligjor, 7 rekomandimet e lëna nga Drejtoria e AB në MB për vitin 2022 janë pasqyruar në pasqyrën nr.2 bashkëlidhur.

✓ *Opinion mbi vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në zbatimin e rekomandimeve;*
Nga auditimi rezultoi se ishte punuar për zbatimin e rekomandimeve të lëna dhe për zbatimin e afateve të përcaktuara në Planin e veprimit, edhe për rekomandimet të rezultuara pjesërisht të zbatuara e në proces nga ana Institucionin e Prefektit Qarkut Elbasan janë marrë masat e duhura procedurale për zbatimin e tyre.

II. HYRJE

Auditimi për zbatimin e rekomandimeve, u krye nga Arbëresha Zyka dhe Maria Markaj, në zbatim të Planit vjetor 2023 miratuar me urdhrin e Ministrit nr.199, datë 17.10.2022, “Për auditimin e brendshëm në strukturat e Ministrisë së Brendshme për vitin 2023”, Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”, autorizimit 2998, datë 16.03.2023 “Autorizim për auditimin e zbatimit të rekomandimeve”, dhe në programin e angazhimit të miratuar me nr.2998/1, datë 16.03.2023. Auditimi u krye gjatë periudhës 16.03.2023 deri me 03.04.2023.

Auditimi u krye sipas identifikimit të çështjeve në Programin e punës:

a) Auditimi i hartimit të Planit të veprimit me persona përgjegjës dhe afate konkrete për zbatimin e rekomandimeve të lëna në Raportin Final të Auditimit ose vlerësimi i riskut nga Titullari në rastet e mospranimit të rekomandimit (marrja përsipër e riskut nga Titullari). *Kriteri lidhur me këtë çështje është:* Zbatimi i pikës d, të nenit 12 “Përgjegjësitë e titullarëve të njësisë publike” të ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditin e brendshëm në sektorin publik” dhe pikave: 4.1.12 “Raportet e auditimit dhe plotësimi i plan veprimit nga njësia e audituar” të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik të miratuar me Urdhrin e MF nr.100, datë 25.10.2016, ndryshuar me urdhrin e MFE nr.4 datë 10.01.2020, sipas të cilës duhet të hartohet dhe miratohet Plani i veprimit me persona e afate konkrete për zbatimin e gjithë rekomandimeve dhe të dërgohet zyrtarisht në Drejtorinë e Auditimit në MB, jo më vonë se 30 ditë nga marrja e Raportit Final të Auditimit.

b) Auditimi i caktimit të personit përgjegjës që të evidentojë në një rregjistër sipas statusit të gjitha rekomandimet e lëna nga auditimi i brendshëm, të komunikojë, monitorojë dhe informojë vazhdimisht DA në MB për progresin që është bërë për zbatimin e tyre. *Kriteri lidhur me këtë çështje është:* Zbatimi i pikës 4.1.13.3 “Përgjegjësia e njësive për të zbatuar rekomandimet e AB”, të MAB, sipas të cilës subjekti i audituar duhet të dërgojë emrin e personit përgjegjës që të evidentojë të gjitha rekomandimet e bëra nga auditimi i brendshëm dhe të komunikojë, monitorojë dhe informojë vazhdimisht DA në MB për progresin që është bërë për zbatimin e tyre.

c) Auditimi i evidentimit të zbatimit të rekomandimeve të dhëna sipas afatit të parashikuar në Planin e veprimit dhe të personave përgjegjës në rastet e mosrespektimit të afatit për zbatimin e rekomandimeve. *Kriteri lidhur me këtë çështje është*: Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar nenit 9, pika 2 e komponentët e tij; Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të hartuar nga subjekti audituar bazuar në ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe Manuali i Auditimit të Brendshëm.

Pas analizës së dokumentacionit mbështetës lidhur me procesin e zbatimit të rekomandimeve, u mbajt Akt-verifikimi në vend dhe sipas pikave të programit u hartuan pasqyrat (Pasqyra 1 dhe pasqyra 2), sipas kërkesës së Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”. Raporti Final i Auditimit u hartua mbi bazën e Aktit të verifikimit dhe pasqyrave referuese duke i administruar në dosje.

III. METODA EAUDITIMIT

Në zbatim të autorizimit të miratuara nga Drejtuesi DA në MB, Grupi punës hartoi Programet e punës sipas kriterëve ligjore që lidhen me procesin e zbatimit të rekomandimeve të cilat u miratuan nga Drejtori i DA dhe u verifikua në vend zbatimi i rekomandimeve duke bërë ballafaqimet me dokumentacionin përkatës.

Gjatë auditimit u përdor metoda e intervistimit/ pyetësorëve dhe analizimi i dokumentacionit lidhur me procedurat e ndjekura nga organizata e audituar për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e kryera nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm gjatë vitit 2022 dhe zbatimin e rekomandimeve të mëparëshme (sipas kërkesave të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”).

Për kryerjen e auditimit, u konceptuan dy pasqyrat bashkëlidhur Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”, dhe mbi bazën e rezultateve të pasqyruara në këto pasqyra, u mbajt Akt-verifikimi në vend në subjektin e audituar, në vijim u hartua Raporti Final i Auditimit duke bashkëlidhur pasqyrën përkatëse nr.2.

IV. GJETJET, KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET

Subjekti i Audituar: Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan

Njësitë/ subjektet e interesuara nga gjetjet: Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan; Ministria e Brendshme.

Përmbledhja e bazës ligjore:

- Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, “Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në sektoin publik” i ndryshuar;
- Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”.
- Urdhri i Ministrit të Brendshëm nr.268, datë 01.07.2021 “Për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm”.

1) Hartimi i Planit të veprimit me persona përgjegjës dhe afate konkrete për zbatimin e rekomandimeve, të lëna në Raportin Final të Auditimit ose vlerësimi i rrishtit nga Titullari në rastet e mospranimit të rekomandimit (marrja përsipër e rrishtit nga Titullari).

Nga auditimi në vend për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve rezultoi se, Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan kishte hartuar planin e veprimit (brenda afatit ligjor, jo më vonë se 30 ditë nga marrja e Raportit Final të Auditimit) për zbatimin e rekomandimeve të lëna në Raportin Final të Auditimit. Sipas Planit të veprimit ishin përcaktuar personat përgjegjës dhe afatet konkrete të zbatimit të rekomandimeve të lëna në Raportin Final të Auditimit, në përputhje me përcaktimet e pikës d, të nenit 12 “Përgjegjësitë e titullarëve të njësive publike” të ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditin e brendshëm në sektorin publik” dhe pikave: 4.1.12 “Raportet e auditimit dhe plotësimi i plan veprimit nga njësia e audituar” të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik të miratuar me Urdhrin e MF nr.100, datë 25.10.2016, ndryshuar me urdhrin e MFE nr.4 datë 10.01.2020. Institucioni ka hartuar miratuar dhe dërguar në DA në MB “Planin e veprimit” të zbatimit të rekomandimeve dhe me shkresën nr.1527/6, datë 17.06.2022, në të cilin janë përfshirë të gjitha rekomandimet, është përcaktuar personeli për zbatimin e rekomandimeve si dhe afatet e zbatimit të tyre.

2) Caktimi i personit përgjegjës që të evidentojë në një rregjistër sipas statusit të gjitha rekomandimet e lëna nga auditimi i brendshëm, të komunikojë, monitorojë dhe informojë vazhdimisht DA në MB për progresin që është bërë për zbatimin e tyre.

Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan në dërgimin e planit të veprimit në MB, kishte përcaktuar personin përgjegjës Sekretari i Përgjithshëm zj.Lorena Balliu, në muajin Janar 2023 me Urdhër të Titullarit është caktuar shefi i sektorit të Zhvillimit Urban z.Anesti Kapurani, për ndjekjen dhe raportimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga DA në MB. Bazuar në përcaktimet e pikës 4.1.13.3 të Manualit të AB , e cila ka të bëjë me “Monitorimin në mënyrë të vazhdueshme nga menaxhimi i zbatimit të plan veprimit dhe raportimi periodikisht në DAB në MB i progresit të bërë për zbatimin e rekomandimeve të lëna dhe sipas planit të veprimit. Raportimi të ketë informacionin të plotë dhe të mbështetur në dokumentacionin që tregon masat e marra për zbatimin e rekomandimeve” rezulton se, institucioni ka kryer monitorimin e zbatimit të rekomandimeve duke bërë të mundur respektimin e afateve të përcaktuara e miratuara nga vetë institucioni në plan veprim, mundësimi i respektimit të afateve konsiston për ato rekomandime që janë në proces realizimi e lidhen me faktorët e jashtëm. Njëkohësisht ka raportuar në DA në MB statusin e progresit të zbatimit të rekomandimeve sipas plan veprimit.

3) Evidentimi i zbatimit të rekomandimeve të dhëna sipas afatit të parashikuar në Planin e veprimit dhe të personave përgjegjës në rastet e mosrespektimit të afatit për zbatimin e rekomandimeve.

Për gjetjet e konstatuara gjatë procesit të auditimit, nga Drejtoria e Auditimit janë lënë për ndjekje dhe zbatim gjithsej 9 rekomandime (nga të cilat 2 rekomandime kanë rezultuar nga auditimet e mëparshme dhe 7 rekomandime janë lënë nga auditimi i fundit) të cilat janë pranuar dhe ka filluar zbatimin e tyre, duke përfunduar së realizuari 7 rekomandime ose 78 %, ndërsa 2 rekomandime ose 22 %, ishin në proces zbatimi por pa përfunduar plotësisht. Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi është detyrim ligjor, 7 rekomandimet e lëna nga Drejtoria e AB në MB për vitin 2022 janë pasqyruar në pasqyrën nr.2 bashkëlidhur.

Niveli i realizimit të 7 rekomandimeve të lëna në auditimin e fundit sipas llojit të tyre, paraqitet si më poshtë:

- a). Rekomandime për përmirësimin e sistemeve: Janë lënë 4 rekomandime dhe janë zbatuar 3 dhe 1 rekomandim në proces zbatimi.
- b). Rekomandime për përmirësimin e kuadrit ligjor: Nuk ka rekomandim.
- c). Rekomandime me karakter organizativ: Janë lënë 3 rekomandime të cilat janë zbatuar.
- d). Rekomandime për arkëtim: Nuk ka rekomandim.

Ndërsa lidhur me 2 rekomandimet e mbartuara nga auditimet e mëparëshme është bërë verifikimi i tyre dhe janë përfshirë në aktverifikimin dhe rezulton se 1 rekomandim është zbatuar dhe 1 rekomandim është në proces zbatimi.

Gjetje nr. 1: Moszbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparëshme.	
Përshkrimi i gjetjes:	<p>Situata: 9 rekomandime (nga të cilat 2 rekomandime kanë rezultuar nga auditimet e mëparëshme dhe 7 rekomandime janë lënë nga auditimi i fundit) të cilat janë pranuar dhe ka filluar zbatimi i tyre, duke përfunduar së realizuari 7 rekomandime, ndërsa 2 rekomandime janë në proces zbatimi por pa përfunduar plotësisht.</p> <p>Kriteri: Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe komponentët e tij; plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të hartuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan, bazuar në Ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe pika 4.1.13.3 “Përgjegjësia e njësisë për të zbatuar rekomandimet e AB” i Manualit të i Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e MF nr.100, datë 25.10.2016, ndryshuar me urdhrin e MFE nr.4 datë 10.01.2020.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Moszbatueshmëria e plotë e rekomandimeve ndikon në funksionimin e kontrollit të brendshëm të sistemeve të veprimtarisë së institucionit.</p> <p>Shkaku: Nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan janë marrë masat e duhura procedurale por rezulton se zbatimi i plotë i tyre lidhet edhe me faktorë të jashtëm (institucione të tjera bashkëvepruese).</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I mesëm
Konkluzioni	Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan kishte punuar për zbatimin e rekomandimeve por nuk është arritur në zbatimin e plotë të rekomandimeve referuar edhe faktorëve të jashtëm (institucione të tjera bashkëvepruese).
Rekomandimi	Menaxhimi lartë i Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan, të marrë në analizë rekomandimet në proces dhe pjesërisht të zbatuara dhe të vendosë procedura për t’u siguruar se çdo rekomandim i lënë nga DAB, zbatohet ashtu siç duhet si dhe të kryejë raportimin periodik mbi statusin e zbatimit të rekomandimit.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Sipas Planit të veprimit të hartuar nga organizata.

V. PËRMBLEDHËSE E REKOMANDIMEVE:

Zbatimin e rekomandimeve të AB sipas afatit të përcaktuar në Planin e veprimit dhe raportimi mbi progresin e realizimit të tyre deri në përfundimin e plotë të realizimit të tyre, është detyrim ligjor. Në zbatim të pikës d, të nenit 12 “Përgjegjësitë e titullarëve të njësive publike” të ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditin e brendshëm në sektorin publik” dhe pikës 4.1.13.3 “Përgjegjësia e njësisë për të zbatuar rekomandimet e AB”, Menaxhimi lartë i Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan, të marrë në analizë rekomandimet e mbetura në proces e pjesërisht të zbatuara dhe të vendosen procedura për t’u siguruar se çdo rekomandim i lënë nga njësia e AB, zbatohet ashtu siç duhet. Personi përgjegjës i caktuar nga ana Juaj,të evidentojë të gjitha rekomandimet e lëna nga auditimi i brendshëm dhe të komunikojë e monitorojë rekomandimet, të informojë vazhdimisht DA në MB për progresin që është bërë për zbatimin e tyre.

GRUPI I AUDITIMIT

Arbëresha ZYKA

Maria MARKAJ

Institucioni i Prefektit Qarku Elbasan

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	
				GJETJET						
Nr.	Subjekti i audituar/rekomandimet	Data e Raportit Perfundimtar (Maj 2022)	Lloji i Auditimit	Sistemi /Fusha	Nensistemi	Niveli i Riskut	Përgjigja e subjektit	Afati i implementimit te rekomandimit	Satusi Rekomandimit	
1	<p>Menaxhimi i lartë i Institucionit, të marrë në analizë rekomandimet e pa realizuara e në proces realizimide të marrë masa për realizimin e plotë të tyre. Të hartojë planin e veprimit duke përfshirë të gjitha rekomandimet, afatin, personin përgjegjës dhe linjat e raportimit tek eprori për zbatimin e tyre.</p> <p>Për rekomandimet e pa zbatuara që i përkasin veprimtarisë së KVVTP-së, shkresërisht dhe të mbështetur në dokumentacionin përkatës, Institucioni t'i dërgojë për ndjekje e zbatim Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK).</p> <p>Institucioni të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme dhe të raportojë periodikisht në DAB në MB progresin e bërë për zbatimin e rekomandimeve të lëna dhe sipas planit të veprimit. Raportimi të ketë informacionin të plotë dhe të mbështetur në dokumentacionin që tregon masat e marra për zbatimin e rekomandimeve.</p>	Maj 2022	Auditim i kombinuar	1 Qeverisja dhe administrimi	1.2 vendimarrja dhe mbikqyrja	lartë	Pranuar plotësisht	Rekomandimi të zbatuar menjëher e vazhdimesi	Rekomandimi plotësisht	

2	Menaxhimi i lartë i institucionit të marrë masa për identifikimin dhe hartimin e regjistrit të rrishtit sipas objektivave përkatës për funksionimin e strukturave përbërëse të Institucionit të Prefektit, të hartohen proceset e punës për çdo post pune në përputhje me kërkesat e Aneksit nr.2 të MFK-së si dhe përmirësimin e funksionimit të kontrollit të brendshëm nëpërmjet 5 komponentëve të MFK-së	Maj 2022	1 Qeverisja dhe administrimi	1.1 Planifikimi strategjik, objektivat; 1.3 Menaxhimi i riskut	I larte	Pranuar plotesisht	Rekomandimi të zbatohet menjehere ne vazhdimesi	Rekomandim i zbatuar plotesisht
3	Prefekti i Qarkut Elbasan, të përcjellë pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, gjetjen e auditit lidhur me pezullimin e lejeve të drejtimit, të lëshuara nga shtetet e huaja të kërkojë nxjerrjen e përgjegjësi për vonesat në dërgimin e praktikave të përcjella pranëInstitucionit të Prefektit. Bashkëlidhur praktikave të përcjella pranë institucionit të Prefektit nga DVPE, të dërgohet dhe gjurma e bërjes me dije të kundravajtësit nga agjenti verifikues (deklaratë, shënim në procesverbalin që i jepet kundravajtësit, të ndryshimeve të fundit të kodit rrugor).	Maj 2022	1 Qeverisja dhe administrimi	1.2 vendimarrja dhe mbikqyrja	I larte	Pranuar plotesisht	Rekomandimi të zbatohet menjehere	Rekomandim i zbatuar plotesisht
4	Menaxhimi i lartë i Institucionit të Prefektit Qarkut Elbasan, të marrë masa të menjëhershme për dorëzimin e dokumentacionit të KVVTP në DVASHK Elbasan dhe për dosjet e KVVTP të cilat kanë rezultuar në procese gjyqësore të dokumentojë në mënyrë shkresore me Avokaturën e Shtetit trajtimin dhe administrimin e tyre.	Maj 2022	1 Qeverisja dhe administrimi	1.2 vendimarrja dhe mbikqyrja	I larte	Pranuar plotesisht	Rekomandimi të zbatohet menjehere	Ne proces zbatimi por i paperfunduar plotesisht

5	<p>Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, çdo fund viti të kryejë rakordimin dhe inventarizimin e certifikatave që përdorim të katër Z. Gjendjeve Civile.Z.GJ.C për certifikatat të cilat gjatë prodhimit të tyre dalin të pa vlefshme, të evidentohen dhe administrohen nga personeli i Z.GJ.C dhe pas vlerësimit të arsyeve të mospërdorimit të tyre të shkarkohen me proces verbal.</p>	Maj 2022						Rekomandim i zbatuar plotësisht	Rekomandimi të zbatohet menjëherë në vazhdimësi	Rekomandim i zbatuar plotësisht
6	<p>Menaxhimi i lartë i Institucionit të Prefektit Qarkut Elbasan, të krijojë mundësinë për ndarjen e rrejtit elektrik të godinës e cila është bashkë me Këshillin e Qarkut dhe pajisjen, instalimin e matësit të energjisë elektrike të Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan.</p>	Maj 2022		6.1 Kontrollat /rregullat/ procedurat e anagazhimit	I mesëm	Pranuar plotësisht	Rekomandimi të zbatohet brenda vitit 2022	Rekomandim i zbatuar plotësisht		
7	<p>Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin, të marrë në evidencë gjetjet e konstatuara nga auditi, të caktojë njësi përgjegjëse / person përgjegjës për administrimin e dokumentacionit mbështetës të vendimeve dhe vulën, për mbajtjen e një regjistri mbi vendimet e marra dhe arkivimin e dokumenteve në përputhje me ligjin. Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin të plotësojë numrin e anëtarëve me përfaqësues nga grupet e interesit, të administrojë njoftimet e anëtarëve për mbledhje dhe të organizojë periodikisht mbledhjet e t'i dokumentojë me procesverbalin e mbledhjes i cili të ketë të dhëna të mjaftueshme për të vërtetuar, pjesëmarrje, ngjarjet, diskutimet dhe konfirmimet e votave të lidhura ngushtë me çështjen e diskutuar. Në fillim të mbledhjes të vihet në dispozicion të anëtarëve të KBU-së, procesverbali i mëparshëm dhe të gjithë dokumentacionin së bashku me kërkesën e subjektit për leje/autorizim.</p>	Maj 2022		1.2 Qeverisja dhe administrimi	I lartë	Pranuar plotësisht	Rekomandimi të zbatohet menjëherë në vazhdimësi	Rekomandim i zbatuar plotësisht		